

Rumeli

RUMELİ İSLÂM ARAŞTIRMALARI DERGİSİ

مجلة روم اهل للبحوث الإسلامية | Rumeli Journal of Islamic Studies

ISSN :2564 -7903 Yıl/Year :3 - İlkbahar/Spring 2020 - Sayı / Issue :5



TRAKYA
ÜNİVERSİTELER BİRLİĞİ
İLAHİYAT FAKÜLTELERİ

RUMELİ

İslâm Arařtırmaları Dergisi

مجلة روم ايلي للبحوث الإسلامية / Journal of Islamic Studies

Yıl / Year: 3 – İlkbahar / Spring 2020 – Sayı / Issue: 5



ISSN: 2564-7903

Dergimizin Tarandıđı Veritabanı ve İndeksler:



Arařtırma Makaleleri / Articles

VAKĒFET E MUTASARRĒFIT TĒ PRIZRENIT MAHMUD PASHĒS

Fahri Avdija*

Geliř Tarihi : 05 Mart 2020

Kabul Tarihi : 29 Mart 2020

Abstrakt:

Mahmud Pasha řherbeu si mutasarrĒf i Prizrenit nĒ gjysmĒn e parĒ tĒ shekullit XIX dhe ishte njĒ nga shtetarĒt mĒ tĒ rĒndĒsishĒm tĒ PerandorisĒ Osmane. Ishte i biri i Tahir PashĒs, i cili gjithashtu ka mbajtur pozita tĒ rĒndĒsishme ne PerandorinĒ Osmane. Si njĒ besimtar mysliman, Mahmud Pasha kishte lĒnĒ shumĒ vakĒfe, madje ai kishte ndĒrtuar njĒ kompleks tĒ tĒrĒ nĒ qytetin e Prizrenit. Ky kompleks pĒrbĒhej nga njĒ xhami, medrese, mejtep dhe dershane. Ai gjithashtu kishte ndĒrtuar edhe tri kulla sahati. NdĒrsa pĒr tĒ mbuluar shpenzimet e vakĒfeve tĒ lartĒcekura, ai kishte lĒnĒ si vakĒf disa dyqane dhe njĒ shumĒ tĒ caktuar parash tĒ gatshme.

FjalĒt kyĒe: VakĒf, Mahmud Pasha, Prizren, Perandoria Osmane, Xhami, Medrese, Mejtep.

PRIZREN MUTASARRIFI MAHMUD PAŐA'NIN VAKIFLARI

Őz:

Mahmud Paőa, XIX. yzyılın ilk yarısında Prizren mutasarrıf gĒrevinde bulunmuř ve Osmanlı Devleti'nin en Ēnemli devlet adamlarından biriydi. Babası olan Tahir Paőa da Osmanlı Devleti'nde Ēnemli gĒrevlerde bulunduđu gĒrőlmektedir. Bir mőmin olarak, Mahmud Paőa birĒok vakıf eserleri bırakmıřtır. Onun geride bıraktıđı Ēnemli eserlerinden biri Prizren řhrindeki kőllyesidir. Bu kőllye cami, medrese, mekteb ve dershanelen oluřmaktaydı. Ayrıca ũ saat-kulesi de inřaa ettiđi bir gerĒektir. SĒz konusu vakıfların masrafları sađlanmak iĒin, bir kaĒ dőkkān ve belirli miktarlarda nakit para da bırakmıřtır.

Anahtar Kelimeler: Vakıf, Mahmud Paőa, Prizren, Osmanlı İmparatorluđu, Cami, Medrese, Mekteb.

FOUNDATIONS OF THE GOVERNOR OF PRIZREN MAHMUD PASHA

Summary

It is historically known that the Waqf institution played an extraordinary role in providing the essential services to Muslim societies. In every period of Islamic history, the Waqf has been a place and a centre of activity ensuring the integration of a society. In addition to providing health care, basic infrastructures, employment opportunities, business activities, food for the hungry, housing for the poor and needy, the waqf also supported the education and religious sectors. The establishment of Waqf in Kosovo dates back to the arrival of the Ottomans. After the Islamization of the Albanians of Kosovo, or in other words, together with their Islamization, the number of Waqfs increased, for the total number of which we have nothing concrete to date. According to a study by the Institute of History of Turkey, today there are 224 Ottoman architectural works in Kosovo, including 124 buildings where worship and other religious rites are performed, 41 buildings for education, 5 for trade, 38 social, 20 military, 12 civil and 6 public buildings. Whereas, the first established Waqf in Kosovo is the Bazaar Mosque in Pristina, in documents also known as the Little

* Doktora Őđrencisi, İstanbul Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitőső, Tarih BĒlőmő, fahriavdija@hotmail.com, Orcid ID: 0000-0002-4506-7810.

İntihal: Bu makale "iThenticate" intihal tarama programında taranmıř ve intihal iĒermediđi tespit edilmiřtir.

Plagiarism: This article has been scanned by iThenticate. No plagiarism detected.

Atıf / Citation: Avdija, Fahri. "VakĒfet e MutasarrĒfit tĒ Prizrenit Mahmud PashĒs"/ "Prizren Mutasarrıfı Mahmud Paőa'nın Vakıfları". *Rumeli İslam Arařtırmaları Dergisi* / 5 (Nisan 2020): 90-100.

Fatih Mosque, whose foundations were laid at the time of Sultan Bayazit I, and completed at the time of Sultan Mehmed Fatih II.

Among those who left great things that can even be compared to the works of the Sultans was Mahmud Pasha bin Tahir Pasha (Mahmud Pasha son of Tahir Pasha) whose waqfs we will talk about below. Mahmud Pasha comes from one of the most popular families in Albanian history, a family which for several decades led the *Sandjak of Prizren*. He was one of the most important statesmen who served as a *Mutasarrif of Prizren* during the first half of the 19th century. As a Muslim believer, Mahmud Pasha left many Waqfs, and he even built an entire complex in the city of Prizren. This complex consists of a *mosque, madrasa, maktab* and *dershane*. To provide money for the expenses and to pay those who would work in his Waqfs, he left as Waqfs five mills, a bakery, a butcher shop, two farrier shops, a barber shop and he also left a certain amount of cash. According to researchers Ismail Eren and Hasan Kaleshi, Mahmud Pasha had also built three watchtowers: one in Prizren, one in the village of Mamusha near Prizren and one in Rahovec.

In addition to leaving Waqf, he is also known for his wars side with Sultan. As is well known, Mahmud Pasha and all other Albanian leaders sometimes were obliged to take part in various wars in which the Ottoman Empire faced other states. However, Mahmud Pasha willingly participated in the Ottoman-Russian war of 1829, and until returning from the expedition, he entrusted the leadership to his brother, Emin Pasha.

The period of Mahmud Pasha's rule coincides with the period when the Ottoman Empire was making reforms in the Balkans. It was the year 1836, when the Ottomans were confronting Mustafa Pasha Bushatli from Shkodra, Mahmud Pasha came to his aid, which led to the disruption of relations with the High Gate. That same year, at the behest of the Sultan, Mahmud Pasha was dismissed from the position of Mutasarrif and sent to Anatolia, where he was executed.

Keywords: Waqf, Mahmud Pasha, Prizren, Ottoman Empire, Mosque, Madrase, Maktabe.

Hyrje

Historikisht është e njohur që institucioni i vakëfit¹ kishte rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në ofrimin e të gjitha shërbimeve themelore për shoqërinë myslimane. Në çdo periudhë të historisë Islame, vakëfi ka qenë njëri prej mjeteve më të rëndësishme i veprimtarive që siguronin integrimin e një shoqërie. Përveç sigurimit të kujdesit shëndetësor, infrastrukturës, mundësive të punësimit, përmirësimit të veprimtarive tregtare dhe afariste, ushqimit për të uriturit, strehimit për të varfërit dhe nevojtarët, vakëfi gjithashtu përkrahu edhe sektorin e arsimit dhe atë religjioz. Edhe pse në Kur'anin famëlartë shprehja “vakëf” nuk përmendet askund, mirëpo format e shprehura si: *të jepet në rrugën e Allahut, të veprohet mirë*, etj., kanë pasur ndikim të madh në krijimin e vakëfeve. Të gjitha ato që ne sot i njohim si xhami, medrese, imarete², teqe, hamame, etj., janë manifestim i konceptit të besimit dhe bamirësisë. Vakëfet, përveç tjerash u bënë urë lidhëse në mes qytetesh, ku përmes tyre u ndërtuan rrugë, ura, hane, etj.³

Në truallin e Kosovës vakëfet e para fillojnë të themelohen që me ardhjen e Perandorisë Osmane. Ndër studiuesit e njohur shqiptarë i cili shkroi për vakëfet e para të themeluara në trojet shqiptare është Hasan Kaleshi. Në kuadër të studimit të dokumentëve më të vjetra në Jugosllavi, ai kishte folur edhe rreth vakfijeve më të vjetra në gjuhën arabe në trojet shqiptare, përfshirë këtu Kosovën, Maqedoninë dhe një pjesë të Shqipërisë.⁴ Ndërsa nga autorët e huaj të

¹ Vakëf është shprehje Arabe, e cila ka kuptimin “pengohet,-të mbahet”. Në terminologjinë juridike Islame domethënë –të mbrohet gjësendi, apo nga personat e tretë, etj., Bkz, Nexhat Ibrahim, *Fjalor Enciklopedik Islam*, (Shkup: Logos-A, 2017), 870.

² Kuzhinë popullore, ku ushqeheshin skamnorët.

³ Bahaeddin Yediyıldız, “Vakıf”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi* (Ankara: TDV Yayınları, 2012), 42: 483.

⁴ Hasan Kaleshi, *Dokumentet më të vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Jugosllavi*, trans. Ismail Rexhepi (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, 2012), 309.

cilët u morën me trashëgimime osmane në Ballkan ishte Ekrem Hakkı Ayverdi, i cili sipas një renditje alfabetike të qyteteve të Jugosllavisë, ka trajtuar edhe monumentet kulturore osmane në Kosovë.⁵ Nga punimet e fundit në lidhje me vakëfet apo arkitekturën osmane në Kosovë janë edhe hulumtimet e fundit të bëra nga Instituti i Historisë së Turqisë, të pasqyruara në një libër dy vëllimor, botuar në vitin 2006.⁶ Gjithashtu mund të përmendim edhe një punim të Raif Virmića-s.⁷

Vakëfet luajtën rol të madh jo vetëm në zgjerimin e kulturës Islame por gjithashtu rol të madh kishin edhe në procesin e përhapjes së Islamit në Ballkan.⁸ Me përqafimin e fesë Islame nga shqiptarët, është rritur edhe numri i vakëfeve, por për një numër total deri me sot nuk kemi diçka konkrete. Sipas hulumtimeve të bëra nga Instituti i Historisë së Turqisë thuhet se sot në Kosovë egzistojnë 224 vepra arkitekturore osmane, përfshirë këtu 124 ndërtesa në të cilat kryhen adhurimet dhe ritet tjera fetare, 41 ndërtesa për edukim, 5 për tregti, 38 shoqërore, 20 ushtarake, 12 civile dhe 6 ndërtesa publike.⁹ Sipas hulumtimeve që kam bërë në arkiva të ndryshme dhe në bazë të dokumenteve të siguara nga Arkivi Osman në Stamboll, shohim se vakëfi i parë i themeluar në truallin e Kosovës me shumë mundësi është Xhamia e Çarshisë në Prishtinë, e cila në dokumente kalon edhe si Xhamia e Vogël Fatih, themelet e së cilës u vunë në kohën e Sulltan Bajazitit I, ndërsa u përfundua në kohën e Sulltan Mehmed Fatihut II.¹⁰ Për këtë ngjarje të rëndësishme të themelimit të këtij vakëfi, informacione të shumta ka dhënë edhe njëri ndër hulumtuesit më të mëdhenj të historisë së Ballkanit, Ekrem Hakkı Ayverdi.¹¹

Në truallin e Kosovës, ndër ata që kanë lënë vepra të mëdha, të cilat madje mund të krahasohen me veprat e Sulltanëve, ishte *Mahmud Pasha bin Tahir Pasha* (Mahmud Pasha i biri i Tahir Pashës) për vakëfet e të cilit do të flasim më poshtë. Para Mahmud Pashës në pozitën e mutsarrëfit të Prizrenit ishte vëllai i tij Said Pasha, ndërsa pas vdekjes të Mahmud Pashës në këtë pozitë kaloi vëllai i tij i vogël Emin Pasha. Nga kjo kuptojmë se anëtarët e familjes së Mahmud Pashës mbajtën pozitën e mutsarrëfit të Prizrenit për një periudhë të gjatë kohore.

Jeta dhe veprimtaria e Mahmud Pashës

Gjatë gjysmës së parë të shek. XIX Sanxhaku i Prizrenit udhëhiqej nga Mahmud Pasha, njëri ndër emrat më të mëdhenj të shtetarëve të Prizrenit. Ai, mori pjesë në Luftën Osmano-Ruse të vitit 1809, pas së cilës fitoi titullin Pasha.¹² Ndërsa pozitën e mutsarrëfit të Prizrenit ai e mori në vitin 1809 pas vëllait të tij, Said Pashës,¹³ i cili kishte humbur jetën në Fushatën Serbe të vitit 1809.¹⁴

Gjatë periudhës sa ishte mutsarrëf, Mahmud Pasha ndërtoi struktura që do të plotësonin nevojat e banorëve. Ai madje ndërtoi një kompleks të tërë, i cili përbëhej nga një xhami, një medrese, një mejtep dhe një dershane¹⁵. Përveç këtij kompleksi ai gjithashtu kishte lënë si vakëfe disa dyqane dhe një shumë të caktuar para të gatshme,¹⁶ për të cilat detajisht do të flasim

⁵ Ekrem Hakkı Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı Mimari Eserleri-Yugoslavya* (İstanbul: İstanbul Fetih Cemiyeti, 2000).

⁶ Mehmet İbrahimgil – Neval Konuk, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserleri*, V. I-II (Ankara: Türk Tarih Kurumu Yayınları, 2006).

⁷ Raif Virmića, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserleri* (Ankara: TTK Yayınları, 1999).

⁸ Kaleshi, *Dokumentet më të vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Jugosllavi*, 18.

⁹ İbrahimgil – Konuk, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserleri*, V. II, xxv.

¹⁰ Osmanlı Arşivi (BOA), *Irade Evkaf [Dosya: 9]*, Gömlek No 76, Sıra: 8.

¹¹ Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı Mimari Eserleri-Yugoslavya*, 158.

¹² *Sicil-i Osmani 3*, haz. Mehmed Süreyya, (İstanbul: Tarih Vakfı Yurt Yayınları, 1996), 3: 923.

¹³ Osmanlı Arşivi (BOA), *Cevdet Dâhiliye [Dosya: 207]*, Gömlek No 10310.

¹⁴ *Sicil-i Osmani 5*, haz. Mehmed Süreyya, (İstanbul: Tarih Vakfı Yurt Yayınları, 1996), 5: 1457.

¹⁵ Bibliotekë, vend për studim.

¹⁶ Vakıflar Genel Müdürlüğü Arşivi (VGMA), *Evkaf Nezareti [Defter: 987]*, sayfa:209, sıra:68.

më poshtë në pjesën e shpjegimit të vakfijes së tij. Ndërsa sipas studiuesve Ismail Eren dhe Hasan Kaleshi, Mahmud Pasha kishte ndërtuar edhe tri kulla sahati: një në Prizren, një në fshatin Mamushë dhe një në Rahovec.¹⁷ Në vitin 1815 kur Mahmud Pasha kishte urdhëruar ndërtimin e Kullës së Sahatit në Muret e Kalasë së Prizrenit, kishte urdhëruar që të vihesh një mbishkrim në gjuhën osmane, nga i cili kuptojmë se Mahmud Pasha kishte marrë pjesë në luftën për pushtimin e Beogradit dhe Smederevës.¹⁸ Gjithashtu vërehet se edhe Kulla e Sahatit në Mamushë, ka pasur një mbishkrim.¹⁹

Mahmud Pasha është i njohur edhe me luftërat e tij që bëri përkrah Sulltanit. Si të gjithë pashallarët tjerë shqiptarë, edhe Mahmud Pasha shpeshherë obligohej që të merrte pjesë në luftëra të ndryshme kur Perandoria Osmane përballej me shtetet tjera, mirëpo në luftën Osmanoruse të vitit 1829 kishte shkuar vullnetarisht. E derisa të kthehej nga ekspedita, udhëheqjen e Sanxhakut të Prizrenit ia kishte besuar vëllait të tij të vogël, Emin Pashës.²⁰

Periudha e mutasarrëflëkut të Mahmud Pashës rasisë me periudhën kur Perandoria Osmane po bënte reforma në Ballkan. Ishte viti 1836, kur Perandoria Osmane po përballej me Mustafa Pashë Bushatliun nga Shkodra, Mahmud Pasha i doli në ndihmë këtij të fundit, çka ndikoi në prishjen e raporteve me Portën e Lartë. Po atë vit, më urdhër të Sulltanit, Mahmud Pasha shkarkohet nga pozita e Mutasarrëfit dhe dërgohet në Anadoll, ku edhe u ekzekutua.²¹

Vakfija e Mahmud Pashës

Kjo vakfije²² është gjetur në Arkivin e Drejtorisë së Vakëfeve në Ankara gjatë kohës kur isha duke bërë disa hulumtime atje. Ky dokument ka rëndësi shumë të madhe për historinë ngase flet për njërin ndër komplekset më të rëndësishme të periudhës së fundit Osmane në Kosovë. Kjo vakfije mban emrin e *Mahmud Paşa bin Tahir Paşa* (Mahmud Pasha i biri i Tahir Pashës) ndërsa përbëhet nga katër faqe dhe në bazë të të dhënave që përmban kuptojmë se është shkruar në vitin h. 1247/ m. 1831. Procesi i regjistrimit të vakëfeve të tij, respektivisht i shkruarjes së kësaj vakfijeje kishte ndodhur në prani të kadiut të Prizrenit, Osman Sylejmanit. Nga pjesa e parë e tekstit kuptojmë se vakfija është shkruar në formën klasike, pra duke filluar me falenderim ndaj Allahut (xh.sh) dhe lutje për profetin Muhammed (s.a.v), duke vazhduar me përmendjen e disa civateve nga Kur'ani dhe thënjeve të Profetit Muhammed (s.a.v), që flasin për rëndësinë e bërjes së veprave të mira në botën kalimtare, më shpresën që të arrihet sukses në botën e amshueshme. Pastaj janë dhënë informata të detajuara në lidhje me vakëfet e tij, mënyrën se si do të funksionojnë, nga do t'i sigurojnë të ardhurat, etj. Si vakëfe të para që ai kishte ndërtuar ishin xhamia dhe mejtepi, afër shtëpisë së tij në Lagjen Terzi, ndërsa më vonë në anën tjetër të xhamisë kishte ndërtuar medresenë me tetë dhoma dhe një dershane. Për mejtepin dhe medresenë e tij nuk kemi informacion se deri në cilin vit kanë egzistuar, mirpo për xhaminë kemi arritur të sigurojmë disa informacione ku tregohet se një herë është restauruar, pastaj është rrënuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, me qëllimin e ndërtimit të xhamisë së re. Sipas aktvëndimit me numër 152/2 të datës 04.07.2001 të lëshuar nga Instituti për Mbrojtjen e Përmendoreve Kulturore të Komunës së Prizrenit, shohim se Bashkësisë Islame të Kosovës i është lejuar restaurimi dhe zgjerimi i xhamisë. Ndërsa sipas aktvëndimit me numër

¹⁷ Hasan Kaleshi – Ismail Eren, “Mahmud Pashë Rrotlla nga Prizreni–përshpirtënimet dhe vakëfnameja e tij”, *Edukata Islame*, 81 (2006), 158.

¹⁸ Kaleshi, Eren, “Mahmud Pashë Rrotlla nga Prizreni–përshpirtënimet dhe vakëfnameja e tij”, 159.

¹⁹ Kaleshi, Eren, “Mahmud Pashë Rrotlla nga Prizreni–përshpirtënimet dhe vakëfnameja e tij”, 160.

²⁰ Osmanlı Arşivi (BOA), *Hatt-ı Hümayun [Dosya: 412]*, Gömlek No 21413.

²¹ Machiel Kiel, “Prizren”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi* (Ankara: TDV Yayınları, 2007), 34: 350.

²² Vakıflar Genel Müdürlüğü Arşivi (VGMA), *Evkaf Nezareti [Defter: 987]*, sayfa:209, sıra:68.

04/4-351-59 të datës 10.04.2003 të lëshuar nga Komuna e Prizrenit për Bashkësinë Islame të Kosovës, kuptojmë se është lejuar ndërtimi i xhamisë së re.²³

Tabela: 1. Veprat monumentale të Mahmud Pashës.

Vendi	Xhami	Medrese	Mekteb	Dershane	Kullë Sahati
Prizren	1	1	1	1	1
Rahovec					1
Mamushë					1

Për të siguruar të ardhura që mundësonin funksionimin normal të vakëfeve të lartpërmendura, ai kishte lënë si vakëfe edhe pesë mullinj, një furrë buke, një dyqan kasapi, dy dyqane nallbani, një dyqan berberi si dhe 15.000 kurush para të gatshme. Dyqanet do të jepen me qira, kurse paratë do të jepen hua, dhe për çdo 10 kurush të huazuar do të rikthehen 11 kurush, kështu që sipas llogaritjeve të bëra, fitimi vjetor do të jetë 2.250 kurush.

Tabela: 2. Vakëfet rrjedhëse të Mahmud Pashës sipas vakfijes së tij.

Lloji i Vakëfit	Mullinj	Furrë buke	Dyqan kasapi	Dyqan nallbani	Dyqan berberi
Prizren	5	1	1	2	1

Pagat dhe shpenzimet e vakëfit janë si në tabelen e mëposhtme:

Tabela: 3. Pagat e punëtorëve të vakëfit dhe shpenzimet tjera.

Shpenzimet	Mujore (Kurush)	Vjetore (Kurush)
Mytevellit ²⁴	16,50	200
Nazirit ²⁵	6,50	80
Naibit ²⁶	1,50	20
Xhamia e Mahmud Pashës		
Imamit	5	60
Hatibit	2,75	33

²³ Në këtë pikë duhet të ndalemi pak dhe të sqarojmë disa gjëra rreth lokacionit të xhamisë dhe emrit të saj. Sipas vakfijes vendi i ndërtimit të xhamisë është Lagjja Terzi, ndërsa xhamia e rindërtuar është në Lagjën Hoqa. Gjithashtu, në asnjërin prej dokumenteve që flasin në lidhje me restaurimin apo ndërtimin e xhamisë së re, nuk kemi hasur emrin *Xhamia e Mahmud Pashës*. Emri i xhamisë në këto dokumente është dhënë në formën *Xhamia e Hoqa Mahallës*. Mirëpo, se a është fjala për të njëjtën xhami, e sqaron Imami i tanishëm i xhamisë, Zaim Qafleshi dhe kryeimami i Bashkësisë Islame në Prizren, Orhan Bislimaj. Sipas tyre, pikërisht në vendin ku sot gjendet Xhamia e Hoqa Mahallës, ka qenë e ndërtuar Xhamia e Mahmud Pashës. “Lagjja Hoqa është lagje e re, ndërsa para disa vitesh edhe kjo pjesë ku sot është ndërtuar xhamia quhej Lagjja Terzi”, shprehet kryeimami Orhan Bislimaj.

²⁴ Udhëheqës i vakëfit.

²⁵ Mbikqyrës i punës së vakëfit.

²⁶ Kadiu (gjykatësi) ose përsioni në vend të gjykatësit.

Ligjeruesit	1,40	17
Myezinit të parë	2	25
Myezinit të dytë	2	25
Kujdestartit të xhamisë	2,90	35
Medreseja		
Myderrisit	100	1.200
Rojtari	3,30	40
Nxënësit (shpenzimet ditore)	66,60	800
Xhamia e Kalasë		
Myezinit	5	60
Mirëmbajtësit	3,30	40
Mektebi		
Mësuesit	11,60	140
Të tjera		
Për lexim të Kuranit	12,5	150
Orëndreqësit të Kalasë	5	60
Imamit të Xhamisë Bejzade	1,50	20
Imamit të Xhamisë së Velishes	2,5	30
Alemdarit të Xhamisë Mehmed Pasha	5	60
Myteveliut të Vakëfit Kukli Beg	1	12

Disa kushte tjera që janë përmendur në vakfije në lidhje me shpenzimet, shfrytëzimin dhe mënyrën e funksionimit të vakëfit janë si më poshtë:

Studentët që banojnë në dhomat e medresesë obligohen që çdo vit gjatë muajit të Ramazanit ta lexojnë nga një hatme²⁷, kështu që në tetë dhoma do të lexohen tetë hatme, ndërsa me detyrën e lëximit të 15 hatmeve në vit për të gjallët dhe të vdekurit nga familja e vakëflënësit u ngarkua imami dhe njëherit mësuesi i mektebit, Halil Efendiu. Kurani i lexuar, -sipas kushteve të lëna nga vakëflënësi, duhet të këndohet për shpirtin e profetëve të Zotit, për shpirtin e të vdekurve dhe për shëndetin e të gjallëve të familjes së vakëflënësit.

Një shumë e caktuar parash duhet të shpenzohet edhe në rastet kur do të ketë nevojë për renovimin e xhamisë, mejtepit dhe medresesë, ndërsa në dritaret e tyre të vendoset letër si masë mbrojtëse nga i ftohti i dimrit.

Një shumë e caktuar nga të ardhurat e vakëfit ishte paraparë të ndahej për blerjen e qirinjve të cilët në netët e muajit të Ramazanit, në festat e bajrameve, në netët e Ragaibit, Miraxhit dhe Beratit do të vendoseshin në brendësi të xhamisë, në minare, në medrese, në mejtep dhe në Xhaminë e Kalasë.

²⁷ Lëximi i Kurani nga fillimi deri në fund, përmendësh apo duke shikuar librin.

Nga 19 persona që paguheshin nga vakëfet e Mahmud Pashës, emrat e vetëm 6 prej tyre janë të përmendur në vakfije: Hatibi i Xhamisë Ramazan Efendiu, Imami i Xhamisë Saim Halil Efendiu, Myezini i Xhamisë Mulla Sylejmani, myderrizi i medresesë El-Haxh Ali Efendiu, myezini i Xhamisë së Kalasë Nexhmi Hafizi dhe mirëmbajtësi i Xhamisë së Kalasë Hasan Efendiu.

Në këtë vakëfije janë dhënë gjithashtu edhe emrat e familjarëve të vakëflënësit, duke u nisur nga stergjyshërit deri të nipat e tij. Disa nga emrat janë: gjyshërit Sylejman dhe Mahmud Aga, babai Tahir Pasha, nëna Hatman Hanëm, motra Shehzade Hanëm, xhaxhai Rrystem Pasha, xhaxhai Abbas Bej, vëllai Jusuf Bej, motra Zehra Hanëm, vëllai Emin Pasha, vëllai Said Pasha dhe djemtë e tij Tahir Pasha dhe Rrystem Pasha, gjyshja Arife Hanëm, stërgjyshja Zehra Hanëm, tezet Azize Hanëm dhe Gylsyn Hanëm, etj.

Ndërsa në fund të vakfijes është sjellur vendimi i gjykatësit, i cili në mënyrë që ta përjetësojë vakëfin, ka sjellur mendimet e disa dijetarëve myslimanë, siç është rasti me Ebu Hanifen i cili mendon se vakëfi mund t'i rikthehet vakëflënësit kurdo që ai kërkon. Mirëpo, mendimi i Ebu Jusufit dhe Muhamedit, njëherazi që të dy nxënësit të Ebu Hanifes, është se malli i cili është lënë si vakëf nuk mund të kthehet asnjëherë. Kështu që edhe vendimi i gjykatësit, - siç ishte e përcaktuar më rregull në Perandorinë Osmane, bazohej në mendimin e këtyre dy të fundit, sipas të cilit vakëfi bëhej i përjetshëm dhe ndryshimi i tij ishte i pamundur, madje edhe nëse një gjë e tillë kërkohet nga vet vakëflënësi.

Puna e udhëheqjes së vakëfit ishte besuar Uzun Molla Sylejmanit (Mulla Sylejmani i Gjatë), njëherësh edhe myezin i parë i Xhamisë së Mahmud Pashës, ndërsa nuk është cekur se kujt do t'i kalojë përgjegjësia e udhëheqjes së vakëfit pas vdekjes së tij, siç zakonisht shihet në shumicën e vakfijeve.

Tabela: 4. Vakëfi i Mahmud Pashës sipas vakfijes së tij.

Themeluesi	Mahmud Pasha bin Tahir Pasha
Viti i themelimit	1247/1831
Numri arkivor	VGMA, 987/209/68
Myteveliu (Udhëheqësi)	Mulla Sylejmani i Gjatë
Kapitali / lloji i vakëfit	Një xhami, një mekteb, një medrese, një dershane, pesë mullinj, një furrë buke, një mishtore, dy dyqane nallbani, një dyqan berberi, 15.000 kurush
Mënyra e funksionimit	Paratë: <i>huazim</i> (kërkohen edhe dëshmitarë) Dyqanet: <i>të lëshohen me qira</i>
Përqinja e transaksionit	<i>Njëmbëdhjetë në dhjetë</i> (%15)
Të ardhurat nga paratë	2.250 kurush
Qëllimi i themelimit të vakëfit	Për xhaminë, medresenë dhe mektebin e tij që kishte ndërtuar në qytetin e Prizrenit

Si në shumicën e rasteve, edhe në këtë vakfije, në pjesën e fundit janë dhënë emrat e dëshmitarëve të cilët kanë qenë pjesë ceremonisë në kohën kur u shkrua kjo vakfije.

Emrat e dëshmitarëve:

Myderris Sylejman Efendi, Hafizkutub Ebubekir Efendi, Myfti Ramazan Efendi, Sheyh Abdylfetah Efendi, Shejh Ibrahim Efendi, Shejh Ahmet Efendi, Shejh Ejub Efendi, Nuri Efendi, Ymer Efendi, Abdullah Efendi, Halid Efendi, Myderris Ebubekir Efendi, Myderris Elhaxh Ali Efendi, Ymer Efendi, Haxhi Abdullah Efendi, Terzi Mahallesi Imam Mehmet Efendi, Imam Halil Efendi, Hakim Mustafa Efendi, Zulfi Efendi, Halid Efendi, Murteza Bej, Abdylfetah Bej, Haznedar Iljaz Aga, Abdi Ağa, Abbas Sipahi, Muhtar Aga, Silahdar Dervish Aga, Ali Aga, Ibrahim Aga, Kurd, Jusuf Efendi, Ipekli Sherif Efendi, Katib Mehmet Ibrahim Efendi dhe të tjeret.

Konkluzioni

Nga ajo që kemi parë deri me sot gjatë studimit të vakfijeve, kemi kuptuar se roli i vakëfit nuk ishte vetëm në aspektin fetar, por ndikim shumë më të madh kishte në aspektin social, kulturor dhe ekonomik. Sigurisht se nga vakëfet e para që u themeluan në truallin tonë, siç janë xhamitë, teqetë, etj., shohim se ngjyrimi fetar ishte shumë më i theksuar, mirëpo më vonë shohim se vakëfi nuk ishte vetëm një vend për adhurim, por ishte edhe një strehimore dhe vend ku ushqeheshin të varfërit, ishte një shkollë, ishte një vend ku njerëzit punonin dhe fitonin para, mbi të gjitha ishte një vendtakim i të gjithë banorëve të një rrethine të caktuar dhe më gjërë.

Vakëfi te ne nuk erdhi për ta zëvendësuar atë që ishte më parë, por ai erdhi vetëm si element shtesë së bashku me Islamin për të lehtësuar dhe bërë jetën e popullatës së këtyre vendëve sa më të shumëngjyrshme. Të tilla ishin edhe vakëfet e Mahmud Pashës nga Prizreni, në të cilat shumë njerëz punonin, besimtarët kryenin obligimet e tyre fetare, nxënësit mësonin, etj.

Vakëfet e vetme të Mahmud Pashës që i kanë mbijetuan kohës janë Kulla e Sahatit të Mamushës dhe ajo e Rahovecit. Për medresenë dhe mektebin nuk dihet asgjë, ndërsa xhamia u shkatërru në vitin 2003 dhe në vend të saj është ndërtuar xhamia e re, e cila mbanë emrin Xhamia e Hoqa Mahalles, mirëpo nga shumica e banorëve njihet si Xhamia e Mahmud Pashës.

Bibliografia / Kaynakça / References

- BOA, Başbakanlık Osmanlı Arşivi, Cevdet – [Dahiliye; 207/10310], Irade – Evkaf; 9/76/8, Hatt-ı Hümayun; 412/21413.
- VGMA, Vakıflar Genel Müdürlüğü Arşivi, [Prizren Vakıfları; VGMA 987/209/68, VGMA 987/209/69, VGMA 987/209/70, VGMA 987/209/71].
- Ayverdi, Ekrem Hakkı. *Avrupa'da Osmanlı Mimari Eserleri-Yugoslavya*. İstanbul: İstanbul Fetih Cemiyeti, 2000.
- Ibrahimgil, Mehmet – Konuk, Neval. *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserleri*. Ankara: Türk Tarih Kurumu Yayınları, 2006.
- Ibrahimi, Nexhat. *Fjalor Enciklopedik Islam*. Shkup: Logos-A, 2017.
- Kaleshi, Hasan. *Dokumentet më të vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Jugosllavi*, perkt. Ismail Rexhepi. Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, 2012.
- Kaleshi, Hasan – Eren, Ismail. “Mahmud Pashë Rrotlla nga Prizreni – përshpirtënimet dhe vakëfnameja e tij”, *Edukata Islame* nr 81, (2006): 151-191.

Kiel, Machiel. “Prizren”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi*. 34: 349-351. Ankara: TDV Yayınları, 2007.

Sicil-i Osmani 3. haz. Süreyya, Mehmed. İstanbul: Tarih Vakfı Yurt Yayınları, 1996.


Sicil-i Osmani 5. haz. Süreyya, Mehmed. İstanbul: Tarih Vakfı Yurt Yayınları, 1996.

Vırmica, Raif, *Kosova'da Osmanlı Mimari Eserleri* (Ankara: TTK Yayınları, 1999).

Yediyıldız, Bahaeddin. “Vakıf”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi* 42: 483. Ankara: TDV Yayınları, 2012.

Shtojca

Vakëfnameja e Mahmud Pashës fq. 1-2.



Vakëfnameja e Mahmud Pashës fq. 3-4.

